

VENDIM
Nr. 559, datë 15.7.2026

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË KURBIN DHE
SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 418 097 430 (katërqind e tetëmbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte, që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Kurbin dhe Shijak, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi në masën 407 196 804 (katërqind e shtatë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e katër) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi në masën 10 900 626 (dhjetë milionë e nëntëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, të cilat u transferohen bashkive Kurbin dhe Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kurbin e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama